

UDHËZIM
Nr. 5/1, datë 21.5.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5,
DATË 27.2.2014, "PËR SHLYERJEN E
DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 5.2.2014, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", pika 3", dhe në vijim të vendimit nr. 5, datë 18.4.2014 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 3 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pas fjalisë së parë shtohet fjalia "Këto pagesa do të kryhen vetëm pas miratimit nga nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave." Miratimi jepet me shkrim ose në rrugë elektronike tek dega e thesarit ku kryhet pagesa.

2. Në pikën 16, 28 dhe 30 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, krahas fjalës "tatimore" shtohet edhe "doganore".

3. Në pikën 30 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014 ndryshon germa "b" dhe shtohet germa "c" si vijon:

"b) Transfertë në një llogari bankare *escrow* kundrejt konsensusit për shlyerjen e detyrimeve tatimore/doganore, të shprehur me një marrëveshje/dokument vërtetues midis subjektit përfitues dhe bankës së nivelit të dytë ku ka llogarinë subjekti, e cila i dorëzohet institucionit pagues. Kjo marrëveshje/dokument të jetë pjesë e dosjes që dorëzohet nga institucioni në thesar për urdhërimin e pagesës. Ministria e Financave, bazuar në marrëveshjen kuadër me bankat e nivelit të dytë, u kërkon këtyre të fundit konfirmimin pranë degëve të thesarit respektive, të hapjes së çdo llogarie bankare *escrow* për subjektet përfituese me referencat përkatëse ku do të kryhet transfertat bankare.

c) Pas paraqitjes në thesar të një vërtetimi nga organet tatimore/doganore që subjekti në fjalë nuk ka më detyrime tatimore/doganore ndaj administratës qendrore."

4. Pika 20 e udhëzimit ndryshon si vijon: "Brenda 10

ditëve pune nga data e alokimit të fondeve, nëpunësit autorizues urdhërojnë në thesar kryerjen e pagesave për detyrimet e prapambetura, duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit sipas listës së miratuar. Në rastet e mosurdhërimit në kohë dhe të paargumentuar të pagesave si më lart, përgjegjësi i degës së thesarit bllokoi pagesat e njësive respektive deri në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura."

5. Pas pikës 30 shtohet pika 30/1 me këtë përmbajtje:

"a) Në rast të paraqitjes së urdhrave të sekuestros nga shërbimi përbarimor, në zbatim të neneve 581, 582 dhe 583 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ministria e Financave nëpërmjet Njësive të Posaçme të Administrimit dhe Monitorimit të Detyrimeve të Prapambetura (NJPAMDP) kryen veprimet e mëposhtme:

i) Bën verifikimin për ekzistencën e detyrimit të prapambetur që Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme, sipas kuptimit të dhënë në pikën 1 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, mund të ketë ndaj subjektit që rezultoi debitor në urdhrin për vendosjen e sekuestros të dërguar nga shërbimi përbarimor.

ii) Në rast të ekzistencës së detyrimit NJPAMDP-ja dërgon pranë degës përkatëse të Thesarit urdhrin e sekuestros të dërguar nga shërbimi përbarimor, duke vënë në dijeni edhe shërbimin përbarimor.

b) Dega përkatëse e Thesarit, në momentin që merr urdhrin e pagesës nga Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme, njofton menjëherë shërbimin përbarimor përkatës për llogarinë bankare në të cilën do të kryhet pagesa e detyrimit të prapambetur.

c) Dega përkatëse e Thesarit kryen transferimin e vlerës së detyrimit të prapambetur në llogarinë bankare të subjektit/individit vetëm pasi të kenë kaluar pesë ditë pune nga momenti i njoftimit të shërbimit përbarimor për llogarinë bankare në të cilën do të kryejë transferimin e pagesës."

6. Për çdo procedurë të kryer sipas këtij paragrafi, dega e Thesarit mban një dosje të plotë, ku përfshihen urdhrat e përbaruesve gjyqësorë për vendosjen e sekuestros dhe korrespondenca me përbaruesit gjyqësor.

7. Shtojca 1 e udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014 ndryshon sipas formateve bashkëlidhur.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

SHTOJCA 1/A: RAPORTIMI I PAGESAVE TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA PËR INVESTIMET PUBLIKE

[illegible]

SHTOJCA 1/B: RAPORTIMI I PAGESAVE TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA PËR SHPENZIMET PËR MALLRA DHE SHËRBIME

[illegible]

VENDIM
Nr. 28, datë 15.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 13.3.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 4 Akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Feride Dautaj, Alba Qirjako, Tatiana Bardhi, Lavdie Sinanaliaj, Festim Sinanaliaj, Gjinovefa Xhemalaj, etj.

SUBJEKT I INTERESUAR: Fatos Muço, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 470, datë 26.2.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 742, datë 16.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2012-682, datë 2.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 470, datë 26.2.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 742, datë 16.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 -30 dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të ish-pronares Nabile Sinanaliaj. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 408, datë 11.2.1994, është vërtetuar fakti juridik i bashkëpronësisë së kësaj shtetase, mbi një sipërfaqe toke të ndodhur në Paska, Orikum. Me vendimin nr. 94, datë 21.3.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë ka njohur të drejtën e pronësisë së Nabile Sinanaliaj dhe Sade Shabani, mbi një sipërfaqe toke prej 13 ha dhe 800 m², dhe kthimin e një sipërfaqeje prej 10 000 m², duke marrë secili bashkëpronar nga 5 000 m², në vendin e quajtur “Paska”, në Orikum, me kufij të përcaktuar.

2. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 782, datë 22.3.1995, është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së trashëgimlënësës së kërkuesve mbi një sipërfaqe trualli të ndodhur në Orikum. Me vendimin nr. 94/1, datë 6.5.1996 të KKKP-së Vlorë, është vendosur njohja e të drejtës së pronësisë mbi 23 ha dhe kthimi edhe i 5 000 m² plus për secilin bashkëpronar.

3. Subjekti i interesuar Fatos Muço, trashëgimtar i shtetasit Skënder Muço, i është drejtuar, gjithashtu, KKKP-së Vlorë për njohjen pronar dhe kthimin e një sipërfaqeje truall. Me vendimin nr. 415, datë 27.9.1996, KKKP-ja Vlorë e ka refuzuar këtë kërkesë, duke e orientuar subjektin e interesuar t’i drejtohet gjykatës, pasi prona e pretenduar prej tij ishte disponuar tashmë me vendimin nr. 94/1994 të këtij organi. Duke pretenduar se prona e disponuar me vendimet e lartpërmendura të KKKP-së, është në pronësi të trashëgimlënësit të tij, shtetasi Fatos Muço i është drejtuar gjykatës me padi me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 415/1996 të KKKP-së Vlorë, si edhe anulimin e vendimeve nr. 94/1994 dhe 94/1/1996 të KKKP-së Vlorë. Në këtë proces, pala e paditur (kërkuesit) ka paraqitur kundërpadi me objekt goditjen për falsitet të hartës së paraqitur nga pala paditëse (subjekti i interesuar).

4. Me vendimin nr. 470, datë 26.2.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur si rrëzimin e padisë, ashtu edhe të kundërpadisë, si të pambështetura në prova e në ligj.

5. Me vendimin nr. 742, datë 16.7.2010, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 470, datë 26.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për sa i përket rrëzimit të kundërpadisë..... Ndryshimin e

vendimit për pjesën tjetër në këtë mënyrë: Ndryshimin e vendimeve nr. 415, datë 27.9.1996 të KKKP-së Vlorë, nr. 94, datë 21.3.1994 dhe nr. 94/1 datë 6.5.1996 të KKKP-së Vlorë dhe detyrimin e të paditurve kundërpaditës... të njohin pronësinë dhe t'u kthejnë në natyrë trashëgimtarëve të ish-pronarit Skënder Muço parcelën prej 30 vreten, në vendin e quajtur "Paska", fshati Dukat, Bashkia Orikum..."

6. Me vendimin nr. 00-2012-682, datë 2.4.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Murat Shabani, Nabile Sinanaliaj, Dashmir Shabani, Gjinovefa Xhemali, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

II

7. **Kërkuesit**, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të shtetases Nabile Sinanaliaj, palë e paditur në procesin civil të kundërshtuar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të tri shkallëve të gjykimit, duke paraqitur këto shkaqe:

7.1. Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjykata e apelit ka zhvlerësuar vendimet e KKKP-së Vlorë nr. 94/1994 dhe nr. 94/1/1996. Bazuar në ligjin e kohës, e drejta e pronës njihet vetëm me anë të vendimeve administrative të KKKP-ve përkatëse. Nuk rezulton që subjekti i interesuar të ketë ushtruar ankim kundër vendimit nr. 415/1996 të KKKP-së Vlorë, ku të kërkohej anulimi i aktit administrativ dhe e drejta e pronës së këtij subjekti. Në gjykim është kryer efektivisht ndryshimi i përmbajtjes së atij vendimi, çka nuk mund të bëhet nga gjykata, pasi në këtë padi në thelb kërkohet njohja e të drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës familjes Muço, kërkesë që nuk është pranuar nga KKKP-ja Vlorë, pasi nuk përmbusheshin kriteret.

7.2. Gjykata e Apelit Vlorë, në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka lejuar ndryshimin e objektit të padisë dhe shkakut ligjor të saj. Vendimet e KKKP-së janë akte që kanë dalë përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri për kthimin dhe kompensimin e pronave (nr. 9235/2004), kurse gjykata e apelit e ka gjykuar objektin e padisë bazuar në një ligj, i cili nuk ka fuqi prapavepruese.

7.3. Në gjykim nuk është thirrur Avokatura e Shtetit, në kundërshtim me nenin 79/a të KPC-së. Gjykatat, duke mos e njoftuar këtë subjekt për gjykimin, nuk i kanë dhënë mundësinë për të marrë pjesë në gjykim, për të mbrojtur interesat e shtetit, duke cenuar parimin e kontradiktoritetit, i parashikuar në nenin 20 të KPC-së.

7.4. Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit.

8. **Subjekti i interesuar Fatos Muço**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar se:

8.1. Kërkuesit kanë kërkuar, mes të tjerash, edhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili ka rrëzuar si padinë, ashtu edhe kundërpadinë, ndaj ky kërkim i tyre është jologjik. E pabazuar është edhe kërkesa për pezullim, pasi vendimi është ekzekutuar tashmë, prona objekt gjykimi është regjistruar në emër të trashëgimlënësve të shtetasit Fatos Muço, ndaj nuk ka çfarë të pezullohet.

8.2. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, rekursi i paraqitur në atë Gjykatë ishte i pambështetur në ligj, çka del qartë edhe në kërkimet përfundimtare ku kërkohet "prishja e vendimit... dhe pushimi i çështjes". Në dispozitat e KPC-së, pushimi i gjykimit vendoset vetëm në rast të heqjes dorë nga gjykimi i çështjes ose i mosparaqitjes së paditësit dhe referimi që bëhet në nenin 485/c të KPC-së është i gabuar.

8.3. Pretendimet e kërkuesve se ndodhemi para gjësë së gjykuar, si dhe para padisë së rivendikimit, ndonëse nuk përbëjnë objekt të gjykimit kushtetues, janë të pabazuara edhe në thelb. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si pasojë e ndryshimit të vendimeve të KKKP-së, është vetë komisioni që e ka orientuar subjektin e interesuar t'i drejtohet gjykatës për kthimin e pronës së tij.

8.4. Në lidhje me pretendimin e zbatimit të ligjit nr. 9235/2004, edhe pse të dy ligjet kanë pothuajse të njëjtat parashikime, në asnjë pjesë të vendimit të gjykatës së apelit nuk ka referencë në këtë ligj, pra ngelet që referimi në pjesën hyrëse të jetë një gabim material, për më tepër që dhe kërkimet në padi janë mbështetur në ligjin nr. 7698/1993.

8.5. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të Avokaturës së Shtetit, ai është haptazi i pabazuar, pasi jo vetëm që kërkuesit nuk kanë asnjë interes të përbashkët me këtë subjekt, por thirrja ose jo e tij në gjykim është objekt i zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme.

III

Lidhur me kërkesën për pezullim

9. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 470, datë 26.2.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të ndryshuar me vendimin nr. 742, datë 16.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuar

10. Bazuar në nenin 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Shterimi i mjeteve kërkon që individit të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara. Ai përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuar, përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuar t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimi se Gjykata e Apelit Vlorë, në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të KPC-së, ka lejuar ndryshimin e objektit të padisë dhe shkakut ligjor të saj, nuk rezulton që të jetë ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, në lidhje me këtë pretendim, kërkuar nuk kanë shteruar mjetet e ankimit, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

12. Në lidhje me pretendimin se në gjykim nuk është thirrur Avokatura e Shtetit, çka, sipas kërkuar, përbën cenim të parimit të kontradiktoritetit, Gjykata vlerëson se kërkuar nuk legjitimohen, pasi ata mund të pretendojnë para kësaj Gjykate vetëm cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe nuk mund të mbrojnë të drejtat e individëve/subjekteve të tjerë. Për më tepër, kërkuar e lidhin praninë e këtij subjekti me mbrojtjen e të drejtave të shtetit dhe nuk kanë argumentuar se në ç’mënyrë, kjo shkelje e pretenduar, i ka prekur në të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

13. Kërkuar pretendon se në bazë të parimit të sigurisë juridike, vendimet e KKKP-së, që kanë disponuar për njohjen pronarë dhe kthimin e pronës trashëgimlënësve të tyre, nuk mund të viheshin më në diskutim nga gjykatat dhe se subjekti i interesuar mund të njihej pronar vetëm në rrugë administrative, pra me vendim të po këtij komisioni.

14. Në jurisprndencën e saj, Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se subjekti i interesuar i është drejtuar KKKP-së, për njohjen pronar dhe kthimin e pronës, dhe pasi ky organ i ka refuzuar kërkesën, me arsyetimin se ishte shprehur njëherë për atë pronë, e ka orientuar subjektin e interesuar t’i drejtohet gjykatës. Në këto kushte, vendimet e KKKP-së Vlorë janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, dhe në përfundim të gjykimit, bazuar në provat e administruara dhe aktet e ekspertimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se midis pronave ka mbivendosje dhe se subjekti i interesuar ka arritur të provojë titullin e pronësisë, në ndryshim nga trashëgimlënësit e kërkuar, të cilët janë mbrojtur me anë të vendimeve gjyqësore të vërtetimit të faktit.

16. Gjykata ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës kërkon, gjithashtu, që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet jo vetëm me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t’i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individit ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike. Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari i drejton organeve përkatëse të administratës publike dhe nëse individit kërkuar nuk është dakord me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë. Gjatë

shqyrtimit gjyqësor, përveç të tjerave, hetohet e vërtetohet dhe fakti nëse subjekti i është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe çdo vendim gjykate që do të anulonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës të administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tij të pronësisë. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e tillë, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të KKKP-ve, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor (*shih vendimin nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të KKKP-së nga ana e gjykatës, nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike dhe, për pasojë, ky pretendim i kërkuarve është i pabazuar.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuarët pretendojnë se vendimi i Kolegjit Civil nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi ai nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar lidhur me shkaqet që e kanë çuar në mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore.

19. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, vlerësimi i zbatimit të këtij parimi bëhet rast pas rasti, pasi detyrimi i gjykatave për ta respektuar atë ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se, në këtë drejtim, neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (neni 480). Nga parashikimet e këtyre dispozitave të KPC-së, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata ka vlerësuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se

kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs pala e paditur (trashëgimlënësit e kërkuësve), por nuk përmban shkaqet që ata kanë parashtruar në rekurs. Në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos ketë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

23. Gjykata, nisur nga sa u argumentua më sipër, si dhe bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj në këtë drejtim, vlerëson se, edhe në rastin konkret në shqyrtim, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.¹

- Shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-682, datë 2.4.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari

Anëtare kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pjesërisht pretendimet e kërkuësve Feride Dautaj etj. dhe ka shfuqizuar, si të papajtuësëm me Kushtetutën, vendimin nr. 00-2012-682, datë 2.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, sikurse jam shprehur dhe më parë (*shih mendimin paralel të vendimeve nr. 31, datë 10.7.2013; nr. 26, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 20.5.2013; nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*), nuk jam në një mendje me argumentet në të cilat ajo e mbështet vendimin e saj.

2. Paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin tim, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, mbetet skematike dhe e padobishme, pa vlerësuar atë që është më e rëndësishme në një vendim gjyqësor, pikërisht pjesën arsyetuese e cila lidhet drejtpërdrejt me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Një qëndrim i tillë i shumicës, mbi të gjitha, jo vetëm anashkalon jurisprudencën e kësaj Gjykate lidhur me unitetin dhe logjikën e vendimit në të gjitha elementet përbërëse të tij, por edhe nuk i shërben aspak kërkuësve, e cila pretendimet e saj për proces të parregullt ligjor i lidh me cenimin e të drejtave të saj kushtetuese. Megjithëse vendimit objekt shqyrtimi të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i mungon tërësisht pjesa arsyetuese, pra vlerësimi i pretendimeve të kërkuësve të parashtruara në rekursin e tyre, shumicës i “intereson” vetëm përshkrimi i pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit. Shumica, ndonëse me të drejtë, në vendim, i referohet dhe nenit 310/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, më tej, në arsyetimin e saj, në mënyrë alogjike dhe kontradiktore bën një shkëputje formale të këtyre elementeve përbërëse, duke i dhënë vlerë të veçantë pjesës hyrëse në të cilën zënë vend parashtrimet e pretendimeve të palëve.

¹ Gjyqtarët B. Dedja dhe V. Kristo votuan për pranimin e kërkesës me mendim paralel.

3. Duke përmbledhur mendimin tim tashmë të njohur, vlerësoj se një riformulim i vendimit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në linjën e kërkuar nga shumica e kësaj Gjykate, nuk i shërben efektivitetit të gjykimit kushtetues. Përveç formalizmit, ky vendim nuk përmbush pritshmëritë e kërkuësve, të cilët, në këto rrethana, mund t'i drejtohen përsëri kësaj Gjykate lidhur me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e pretenduara dhe të mbetura pa përgjigje.

4. Përfundimisht, në vlerësimin tim, mungesa në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e pjesës arsyetuese, pa nënvlerësuar aspak pjesët e tjera të tij të cilat së bashku përbëjnë një unitet, cenon në thelb standardin e arsytimit të vendimit. Mungesa e kësaj pjese, nga ana tjetër, i heq mundësinë Gjykatës për të vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese pretendimet e kërkuës në raport me vendimmarrjen e gjykatës më të lartë të sistemit të juridiksionit të zakonshëm. Një qëndrim i kundërt, si në rastin në fjalë, jo vetëm bie ndesh me Kushtetutën dhe standardin e vendosur nga kjo Gjykatë, por njëkohësisht e bën vendimmarrjen e saj formale dhe aspak efektive.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuës Feride Dautaj etj., jemi kundër qëndrimit të shumicës për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-682, datë 2.4.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vetëm me argumentin se në vendim mungon parashtrimi i shkaqeve të ngritura në rekurs.

2. Pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura në kërkesë, shumica ka vlerësuar se pretendimi se Gjykata e Apelit Vlorë ka lejuar ndryshimin e objektit të padisë dhe shkakut ligjor të saj, nuk mund të merret në shqyrtim, pasi ai nuk është ngritur më parë në shkallët e tjera të gjykimit, pra kërkuësit nuk kanë shteruar mjetet e ankimit, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kurse pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike e ka konsideruar si haptazi të pabazuar. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuësit kanë pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar lidhur me shkaqet që e kanë çuar në mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata, në lidhje me këtë pretendim, ka vlerësuar se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk përmban shkaqet e parashtruara në rekurs, çka përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsytimit të gjykatës (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

3. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se ky qëndrim i Gjykatës, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve të mospranimit nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, është i padobishëm dhe, mbi të gjitha, ai i jep vendimmarrjes të shumicës një karakter formal.

4. Në lidhje me parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ka pranuar, gjithashtu, se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 18, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit është i cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese, ajo nuk mundet që të shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë, vetëm me arsytimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs. Megjithatë, në vlerësimin tonë, kjo nuk e pengon Gjykatën që, edhe në rastet e mospranimit të kërkesës, t'i tërheqë vërejtje Gjykatës së Lartë në mënyrë që të riparojë këto të meta në të ardhmen.

6. Detyrimi që kanë gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 35, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me zbatimin e këtij detyrimi nga ana e Gjykatës së Lartë, për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi, Gjykata ka vlerësuar se mënyra e formulimit të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, se “*rekursi nuk përmban shkaqe ligjore*”, është e rregullt. Fakti se në këtë pjesë të vendimit nuk u jepet përgjigje e detajuar të gjitha pretendimeve të palëve, nuk do të thotë se ky vendim është i paarsyetuar, përderisa shkaqet e parashtruara në recurs, që serviren si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj dhe as në materialet e çështjes. Sipas Gjykatës, kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit dhe nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në drejtim të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Të njëjtin qëndrim mban edhe GJEDNJ-ja, e cila ka vlerësuar se detyrimi që ka një gjykatë vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse dhe se, kur Gjykata e Lartë nuk pranon një recurs për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007 §105; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

8. Bazuar në standardet e mësipërme, vlerësojmë se, në rastin konkret, për sa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se të gjitha shkaqet e ngritura në të nga kërkuesit, edhe pse nuk janë paraqitur formalisht në atë vendim, kanë qenë të pabazuara. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në dhomën e këshillimit ka realizuar një proces vlerësimi të atyre shkaqeve, nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Mungesa e shkaqeve të rekursit në vendim, vetëm formalisht, nuk do të thotë se recursi nuk është marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi (pra se kërkuesit nuk janë dëgjuar), ashtu siç edhe e kundërta e kësaj (një vendim me shkaqe në të) nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se e drejta për t’u dëgjuar është respektuar. Nga kjo pikëpamje, vlerësojmë se ky element i vendimit të dhomës së këshillimit ka karakter thjesht formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

9. Edhe po t’i referohemi nenit 310/1 të KPC-së, i cili parashikon elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, në asnjë nga elementet e pjesës hyrëse, përshkruase apo arsyetuese nuk është parashikuar vendosja e shkaqeve të ankimit. Dispozita kërkon nga gjykata paraqitjen e arsyeve në të cilat ajo mbështet vendimin, që në rastin konkret është mungesa e shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

10. Në përfundim të analizës së mësipërme, vlerësojmë se, për arsye se nga procesi gjyqësor nuk rezulton cenimi i standardeve të një procesi të rregullt ligjor, Gjykata nuk duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, vetëm për arsyen e mosparaqitjes në të, të shkaqeve të rekursit.

Anëtare: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha